



**Hapet thirrja për mobilitete (bursa) studentësh të UPT-së,
në kuadër të Marrëveshjes KA1 të Programit Erasmus+,
në Polytech Orléans, Francë.**

Në kuadër të programit Erasmus + dhe marrëveshjes KA1 bilaterale, është hapur thirrja për aplikime për bursa për studentët e Universitetit Politeknik të Tiranës, **Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike**, në Polytech Orléans.

Llojet e mobilitetit përfshijnë: Shkëmbimin e studentëve të nivelit Master për studime.

Nivelet e mobilitetit për studentët: Studentët duhet të jenë të regjistruar në një program studimi Master në Universitetin Politeknik të Tiranës, Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike.

Kohëzgjatja e bursave: 1 semestër, (semestri i dytë, i vitit akademik 2023 - 2024)

Fusha e studimit: Automotive Engineering (AESM MSc 2023-24)

Numri total i studentëve: 3 studentë

Dokumentat e nevojshme për aplikim:

- CV;
- Kopje e Pasaportës;
- Vërtetim studenti;
- Listë notash e studimeve deri në momentin e aplikimit;
- Letër Motivimi (në gjuhën angleze);
- Çertifikatë e gjuhës së huaj*;
- Dokumenti Learning Agreement**.

**Ofrohen kurset e studimit në gjuhën angleze ku niveli minimal i kërkuar është B2. Studenti duhet të plotësojë nivelin minimal të kërkuar gjuhën duke e vërtetuar me çertifikatën përkatëse të gjuhës së huaj.*

***Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvillohen në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë ‘‘Mobility Plan’’. Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihet në Universitetin Politeknik të Tiranës kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.*

KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në Polytech Orléans lëndë të njëjta ose ekuivalente me ato që do të kryeni në semestrin përkatës në fakultetin tuaj, kjo për arsye që lëndët dhe kreditet t’ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ata që do të zhvillohen në fakultetin tuaj semestrin përkatës, atëherë kur të ktheheni ju duhet të zhvilloni lëndët që nuk përshtaten në Universitetin Politeknik të Tiranës.

Dokumenti ‘‘Learning Agreement’’ te seksioni ‘‘Commitment’’ firmoset nga aplikanti, nga Koordinator i Akademik i Fakultetit dhe nga Zv/Raktori i UPT-së për Anën Shkencore dhe Marrëdhëniet me Jashtë.

Për të shkarkuar formatin e ‘‘Learning Agreement’’ klikoni te:

[Drejtoria e Komunikimit dhe Koordinimit – Universiteti Politeknik i Tiranës \(upt.edu.al\)](https://upt.edu.al) , aneks 2.

Programin e lëndëve të Polytech Orléans, e gjeni te dokumenti bashkëlidhur në PDF: AESM MSc 2023-24



Gjithashtu, klikoni te:

[Master in Automotive Engineering for Sustainable Mobility | Université d'Orléans \(univ-orleans.fr\)](#)

Për t'u njohur me guidën studentore të mirëseardhjes së Universitetit të Orleans - Welcome guide, klikoni te: <https://www.calameo.com/read/005608029fcec107fe658>

Afati për aplikim: Deri më 20 nëntor 2023, ora 12.00

Aplikimi kryhet pranë Drejtorisë së Komunikimit dhe Koordinimit në UPT.

Për informacione shtesë në lidhje me procesin e aplikimit në UPT, mund të kontaktoni në e-mail: abeqo@upt.al , rkodra@upt.al